

Winter 1-2020

“GJUHA E NXITJES DHE E URREJTJES NË MEDIAT E SHKRUARA ELEKTRONIKE NË KOSOVË”

Medina Sherifi

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Communication Commons](#)



Kolegji UBT

Fakulteti për Media dhe Komunikim

**“GJUHA E NXITJES DHE E URREJTJES NË MEDIAT E
SHKRUARA ELEKTRONIKE NË KOSOVË”**

Shkalla Bachelor

Medina Sherifi

Janar, 2020

Prishtinë



Kolegji UBT
Fakulteti për Media dhe Komunikim

Punim Diplome
Viti akademik 2015-2016

Medina Sherifi

**“GJUHA E NXITJES DHE E URREJTJES NË MEDIAT E SHKRUARA
ELEKTRONIKE NË KOSOVË”**

Mentori: Dr. Ferid Selimi

Janar, 2020

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Përdorimi i mjeteve të komunikimit në mediat e shkruara ka shfaqur avantazhe të panumërta lidhur me përhapjen e informacionit drejt një audiencë më të gjerë duke tejkaluar kufijtë gjeografikë si dhe me kosto të ulët ekonomike. Por ndoshta për shkak të natyrës demokratike të përdorimit të mediave online, liria e shprehjes në mjetet e komunikimit online vërehet të përdoret e pakufizuar dhe e pakontrolluar. Gazetarët por edhe individët e thjeshtë mund të postojnë cdo gjë në rrjetet sociale apo portale të ndryshme, pa kriter apo limit, duke cuar rrjedhimisht në rritje të përdorimit të gjuhës së nxitjes dhe urrejtjes. Punimi i kësaj teme u nxit duke marrë parasysh rëndësinë dhe kompleksitetin që kjo teme paraqet, mungesën e informacionit dhe studimeve në këtë fushë në Kosovë, si dhe rëndësinë që ka informimi i duhur i qytetarëve për ndikimet që vijnë nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes në mediat online. Për t'iu përgjigjur pyetjes kërkimore, si metodë hulumtuese është përzgjedhur sondazhi, me anë të shpërndarjes së 50 anketave në qytetin e Prishtinës, Kosovë. Anketat janë shpërndarë në mënyrë rastësore, duke synuar kryesisht grupmoshën 18-55 vjec. Sipas analizimit të të dhënave rezultoi se 64% e të anketuarve e kanë përjetuar gjuhën e urrejtjes.

Fjalë Kyce: gjuha e urrejtjes, nxitje, media online, ndikim, pasoja, Prishtinë,

MIRËNJOHJE DHE FALENDERIME

Ky punim është fryt i një sërë përpjekjeve, përkushtimeve dhe një rruge sfiduese e cila është arritur falë përkrahjes dhe mbështetjes së disa personave të cilët do doja ti falenderoja:

Falënderoj Dr Ferid Selimi, udhëheqësi im shkencor, i cili me përkushtimin, durimin dhe udhëzimet e vazhdueshme më orientoi dhe instruktoi në punimin tim shkencor si dhe rrugën time akademike;

Falënderoj kolegët e mi në Kolegjin UBT, në Fakultetin e Medias dhe Komunikimit, për mendimet dhe idetë e shkëmbyera gjatë punimit të kësaj teme;

Së fundmi, falënderoj familjen time që më qëndroi gjithmonë pranë dhe i jam tejmase mirënjohëse për përkrahjen, durimin dhe mirëkuptimin e pakursyer.

Ju falënderoj,

Medina Sherifi

DEKLARATË AUTORËSIE

Nën përgjegjësi time deklaroj se ky punim është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë përpara një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri apo në pjesë të vecanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonje person tjetër përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	1
1.1 Struktura e Punimit	3
2. SHQYRTIMI I LITERATURËS	4
2.1 Këndvështrimi Historik.....	4
2.2 Kuptimi i Gjuhës së Urrejtjes- Perkufizime	5
2.3 Legjislacioni Mbrojtës	7
2.4 Format më të përhapura të gjuhës së urrejtjes	11
2.5 Ndikimi i përdorimit të gjuhës së urrejtjes online	14
3. DEKLARIMI I PROBLEMIT	17
3.1 Qëllimi i Punimit dhe Pyetja Kërkimore	17
3.2 Objektivat e Punimit	17
4. METODOLOGJIA.....	18
4.1 Qasja Kërkimore	18
4.2 Dizajni Kërkimor	18
4.3 Teknika E Mbledhjes Së Të Dhenave.....	19
4.4 Cështjet Etike	19
5. PREZANTIMI I REZULTATEVE.....	21
5.1 Aspekte të Përgjithshme të Pjesëmarrësve	21
5.2 Aspekte Specifike të Pjesëmarrësve	23
6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	29
7. BIBLIOGRAFIA.....	32

7.1	Burime Shkencore.....	32
7.2	Burime nga Interneti	33

LISTA E SHKURTIMEVE

KNDCP- Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike

AMA- Autoriteti I Medias Audiovizive

PNDCP- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR)

KEGJDR- Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (ICERD)

DUDNJ- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

KE – Këshilli i Europës

KB- Kombet e Bashkuara

LISTA E FIGURAVE

Figura 1- Perkufizime te ndryshme te "Gjuhes se Urrejtjes"	7
Figura 2- Legjislacioni i Kosoves mbi lirin e shprehjes dhe gjuhes se urrejtjes	10
Figura 3- Grupmosha e pjesemarresve	21
Figura 4- Perdorimi i mjeteve te komunikimit online nga pjesemarresit	22
Figura 5- Okupimi i pjesemarresve	22
Figura 6- Kuptimi i gjuhes se urrejtjes nga pjesemarresit	23
Figura 7- Perdorimi i gjuhes se urrejtjes nga pjesemarresit	24
Figura 8-Pjesemarresit pre e gjuhes se urrejtjes ne mediat online	25
Figura 9- Mediat online me te shpeshta te perdorimit te gjuhës së urrejtjes	26
Figura 10- Ndikimi i perjetimit te gjuhes se urrejtjes ne mediat online	27
Figura 11- Pasojat e perdorimit te gjuhes se urrejtjes ne mediat online	28

1. HYRJE

Gjuha e urrejtjes e përdorur në mediat online vështirë se mbetet pa u vënë re. Përmbajtjet që përfshijnë mesazhe të urrejtjes variojnë nga "sulmo një femër" në "vrit një homoseksual" dhe mund të synojnë këdo, pavarësisht nga statusi, gjinia, vendndodhja e kështu me radhë. Edhe në rastet kur gjuha e urrejtjes nuk materializohet në një krim të motivuar nga urrejtja, sërisht konsiderohet të jetë shkaktuar dëm prej saj. Dita ditës viktimat po etiketohen, marginalizohen dhe ekspozohen ndaj stereotipave negative. Pasoja e përgjithshme e gjuhës së urrejtjes në internet mund të jenë dehumanizimi i individëve ose grupeve të individëve. Revolucioni në internet ka ripërcaktuar konceptin e komunikimeve. Krahas ndryshimeve pozitive, të tilla si, fuqizimi i individëve që më parë qëndronin të heshtur, krijimi i një qasje në komunikim më të shpejtë dhe me kosto më efektive, pavarësisht nga vendndodhja e individëve. Për më tepër, Interneti krijoi hapësirë për lirinë e shprehjes për të gjithë, pavarësisht nga statusi dhe aftësitë e tyre, vecanërisht në shtetet që ngurronin të ofronin mundësi të tilla në jetën reale më përpara (Balkin, 2004).

Liria e shprehjes është një ndër të drejtat themelore të garantuara nga instrumentet ligjore kombëtare si dhe ndërkombëtare. Neni 40/1 i Kushtetutës së Kosovës thekson që *“Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime edhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush.”* (Kushtetuta e Kosovës).

Neni 19/2 i Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP) thekson se *“Secili duhet të ketë të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacioneve dhe ideve të të gjitha llojeve, pavarësisht nga kufijtë, qoftë me gojë, me shkrim, në formë të shtypur ose artistike, ose me çdo mjet tjetër të zgjedhur prej tij”*.

(shiko: <https://hrrp.eu/alb/docs/CCPR-a.pdf>).

Por si cdo liri tjetër, edhe liria e shprehjes has dhe i nënshtrohet kufizimeve të caktuara.

Neni 40/2 i Kushtetutës së Kosovës parashikon se *“Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe*

provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare” (Kushtetuta e Kosovës).

Neni 19/3 i KNDCP parashikon që liria e shprehjes i nënshtrohet kufizimeve “*të cilat duhet të përcaktohen shprehimisht me ligj dhe të jenë të domosdoshme (a) Për respektimin e të drejtave ose të reputacionit të të tjerëve; (b) Për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, të rendit publik, të shëndetit ose të moralit publik.”*

(shiko: <https://hrrp.eu/alb/docs/CCPR-a.pdf>).

Falë internetit, zhvillimeve teknologjike dhe modernizimit të mjeteve të komunikimit, tashmë informacioni shpërndahet gjerësisht me atë të mjeteve të komunikimit online, vecanërisht në rrjetet sociale si Facebook, Instagram, Twitter etj. Interneti ka ndryshuar në mënyrë drastike mënyrën e marrjes së lajmeve, komunikimin me miqtë e të afërm, shpërndarjen e informacioneve etj. Natyra e thjeshtë dhe e decentralizuar e rrjeteve sociale, i bën ato lehtësisht të përdorshme duke krijuar një vend të përsosur për profesionistë apo dhe amatorë për të krijuar dhe shkëmbyer ide, informacione, imazhe, video, art, muzikë dhe më shumë.

Përdorimi i mjeteve të komunikimit online ka shfaqur avantazhe të panumërta lidhur me përhapjen e informacionit drejt një audiencë më të gjërë duke tejkaluar kufijtë gjeografike si dhe me kosto të ulët ekonomike. Por ndoshta për shkak të natyrës demokratike të përdorimit të rrjeteve sociale, liria e shprehjes në mjetet e komunikimit online vërehet të përdoret e pakufizuar dhe e pakontrolluar. Gazetarët por edhe individët e thjeshtë mund të postojnë cdo gjë në rrjetet sociale apo portale të ndryshme, pa kriter apo limit, duke cuar rrjedhimisht në rritje të përdorimit të gjuhës së urrejtjes (Alrehili, 2019).

Ky fenomen i ka dhënë hov edhe krijimit të llogarive të ndryshme online që përveç se shfaqin një gjuhë urrejtje ndaj një grupi të caktuar për arsye politike, etnike, gjinore, racore, orientimit seksual etj, ato gjithashtu nxisin frymen e urrejtjes ndaj ketyre grupeve. Grupet e përndjekura online, ndaj të cilëve aplikohet gjuha e urrejtjes dhe nxitja për urrejtje në mjetet e komunikimit masiv online, mund të pësojnë dëmtime të mëdha psikologjike, shpirtërore por edhe fizike, si në rastet kur nxitja është aq e madhe sa që këto individë mund të përndiqen edhe fizikisht.

1.1 Struktura e Punimit

Ky punim është strukturuar si më poshtë:

Kapitulli I – Hyrje, I cili jep një prezantim të përgjithshëm të fenomenit objekt studimi.

Kapitulli 2- Shqyrtimi I Literaturës, I cili jep një këndvështrim të shkurtër historik të zhvillimit të fenomenit; përkufizimet më të rëndësishme të terminologjisë; një përmbledhje të lëgjislacionit mbrojtës si dhe format më të përhapura të gjuhës së urrejtjes dhe ndikimet që ato kanë.

Kapitulli 3- Deklarimi I Problemit, I cili jep qëllimin e punimit, pyetjen kërkimore si dhe objektivat.

Kapitulli 4- Metodologjia. Arsyetohen metodat e zgjedhura kërkimore për këtë punim.

Kapitulli 5- Rezultatet. Analizohen rezultatet e përftuara nga hulumtimi shkencor.

Kapitulli 6- Konkluzioni. Përmbledhen të dhënat më të rëndësishme të punimit.

Kapitulli 7- Bibliografia. Listohen burimet shkencore dhe të internetit në të cilat është bazuar punimi.

2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

2.1 Këndvështrimi Historik

Dallimi racial në SHBA, holokausti në periudhën e Luftës së Dytë Botërore, represioni serb mbi popullsinë shqiptare të Kosovës, që kulmuan në vitet 1998-1999, si dhe konfliktet e shfaqura prej përfundimit të saj e deri më sot e kanë nxitur dhe e kanë mbajtur gjallë gjuhën e urrejtjes (GJERGJI, 2018).

Në shekullin e njëzetë, burimi kryesor i informacionit ishte media tradicionale - shpesh e referuar si "pushteti i katërt", një vëzhgues i publikut me rolin kryesor për të hedhur dritë mbi sjelljet e gabuara të qeverisë dhe abuzimet me pushtetin.

Zhvillimi i internetit dhe teknologjive të reja, coi në lindjen e medias së re- media online, e cila me krijimin e platformave mediatike online zëvendësoi median tradicionale e cila si mjete kryesore informimi kishte gazetat, revistat, radion apo televizionin. Tashmë informacioni shpërndahet më lehtësisht online duke arritur një audiencë më të gjërë e me kosto më efektive.

Mënyra e përhapjes së informacionit dhe komunikimit ndryshoi akoma më shumë me zhvillimin e platformave të rrjeteve sociale të cilat u shfaqën në vitet 1990 (Banks, 2010). Ndryshe nga interneti, që u dha një mundësi grupeve të caktuara të individëve për të shpërndarë idetë e tyre, platformat e rrjeteve sociale krijuan mundësi të barabarta për çdo person në botë, i cili kishte qasje në internet. Platformat rrjeteve sociale si Facebook, Instagram, Snapchat, Twitter etj., thjesht u bënë ndërmjetës midis dy grupeve të njerëzve - përdoruesve privatë që shpërndajnë përmbajtjen dhe audiencën, e cila i merr ato. Mjetet e komunikimit u bënë të arritshme për një numër të madh njerëzish.

Në vijë mësi, informacioni i shpërndarë nga media tradicionale apo online nuk arriti në të njëjtën sukses si rrjetet sociale duke qenë se platformat mediatike janë të kufizuara në shpërndarjen e lajmit nga interesat komerciale apo faktorëve të tjerë. Përkatesisht përmbajtja e lajmeve të portaleve mediatike janë subjekt i mbikëqyrjes së editorialit, duke mos patur

paanësi dhe lirshmëri të plotë në botimin e lajmit, si dhe duke lëkundur herë-herë fuqinë besuese të lajmit nga publiku (Zhu & G., 2018).

Sidoqoftë, këto platforma komunikimi me kosto të ulët dhe me shpejtësi të lartë paraqesnin të metat e tyre. Ato shume shpejt krijuan një “baze fertile” për lehtësimin e përhapjes së gjuhës së urrejtjes dhe nxitjen e saj. Menjëherë pasi platformat e mediave sociale u bënë të njohura, u shfaqën një numër në rritje i grupeve, të cilët ishin të përkushtuar ndaj homofobisë, Islamofobik, anti-emigrant, urrejtje antisemitike, mizogjini etj. (Hanzelka, 2017). Trend i rritjes së gjuhës së urrejtjes duhet të merret në konsideratë në lidhje me një sërë faktorësh, siç është roli i perspektivës liberale për lirinë e shprehjes në zhvillimin e mediave sociale në shekullin XX.

Rrjetet sociale ofruan një mundësi për grupet radikale për të gjetur individë me të njëjtin mendim, për të krijuar bashkëpunim dhe solidaritet kolektiv për një këndvështrim të caktuar ideologjik, për tu lidhur më tej me persona të tjerë dhe për të zgjeruar rrjetin e tyre “ të urrejtjes”. Si pasojë, aftësia për të ndikuar në botë përmes platformave të rrjeteve sociale u rrit dhe, siç është argumentuar, tastierat e sotme të kompjuterit mund të jenë *“edhe më shkatërruese, sesa tanket dhe mitralozët”* (Shaw, 2011, p. 279).

2.2 Kuptimi i Gjuhës së Urrejtjes- Perkufizime

Rëndësia që i është dhënë “gjuhës së urrejtjes” nga institucionet ndërkombëtare daton pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, rreth viteve 1990, ku termi më i përdorur ishte *“të nxisësh urrejtje”*.

Më pas, përkufizimi i “gjuhës së urrejtjes” u parashikua nga Konventa e Krimit Kibernetik, Këshilli I Europës, në vitin 1997.

Termi "gjuhë e urrejtjes" do të kuptohet si mbulim i të gjitha formave të shprehjes që *"përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen racore, ksenofobinë, antisemitizmin ose forma të tjera të urrejtjes bazuar në intolerancë, përfshirë intolerancën e shprehur nga nacionalizmi agresiv dhe etnocentrizmi, diskriminimi dhe armiqësia kundër pakicave, migrantëve dhe njerëzve me origjinë emigrante"* (Këshilli European, 2001).

Ndërsa fjala "urrejtje" do të kuptohet si "ndjenja dhe besime ekstreme negative që lidhen me një grup individësh ose një përfaqësues specifik të atij grupi për shkak të racës, etnisë, fesë, gjinisë ose orientimit të tyre seksual" (po aty).

Për një kohë të gjatë, fokusi ka qenë urrejtja racore, antisemitizmi dhe revizionizmi historik. Së fundmi, kjo temë ka prekur dhe përfshirë ndjeshëm edhe pakicat fetare (veçanërisht fenë myslimane e prekur më shumë nga kërcënimet dhe diskriminimi); orientimin seksual (komunitetin LGBT), invalidët, femrat, etj.

(shiko: <https://al.ejo-online.eu/media-dhe-politika/liria-e-medias/gjuha-e-urrejtjes-rastet-krahasuese-ne-raportet-europiane>).

Termi “ gjuhë e urrejtjes” nënkupton si i tillë përfshirjen e të gjitha formave të shprehjeve që shpërdajnë, nxisin, promovojnë apo arsyetojnë urrejtjen racore, ksenofobinë, antisemitizmin apo forma të tjera të urrejtjes të bazuara në jo-tolerancë, përfshirë: jo-tolerancën e shprehur përmes nacionalizmit agresiv dhe etno-centrizmit, diskriminimit dhe armiqësisë kundër minoriteteve, emigrantëve dhe njerëzve me origjinë imigranti.

Burimi: Komiteti i Ministrave, Rekomandimi Nr. R (97) 20 (faqe 107), shiko: [www.coe.int/t/dghl/standardsetting/hrpolicy/other_committees/dh-lgbt_docs/CM_Rec\(97\)20_en.pdf](http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/hrpolicy/other_committees/dh-lgbt_docs/CM_Rec(97)20_en.pdf)

“Gjuhë që nuk përmban kuptim tjetër përpos shprehjes së urrejtjes për ndonjë grup, sikur një racë e caktuar, posaçërisht në rrethana ku ky komunikim ka gjasa të provokojë dhunë.”

Burimi: Fjalori i Drejtësisë i Black-ut (2009) edicioni i 9-të (faqe 1,529)

“Gjuha urrejtëse është një term që i referohet tërë spektrit të diskursit negativ, duke u nisur nga urrejtja apo paragjykimi dhe deri tek nxitja e urrejtjes. Gjuha urrejtëse është e dizajnuar të degradojë, frikësojë, apo nxis dhunë apo veprime paragjykuese kundër një personi apo grupi njerëzish bazuar në racën, gjininë, moshën, etninë, kombësinë, fenë, orientimin seksual, identitetin gjinorë, invaliditetin, aftësitë gjuhësore, pikëpamjet morale apo politike, klasën socio-ekonomike, punësimin apo dukjen (si gjatësinë, peshën, dhe ngjyrën e flokëve),

kapacitetin mental dhe çfarëdo dallimit-pengese tjetër të tyre. Edhe pse “gjuha”, përfshinë jo vetëm komunikimin oral apo të shkruar por gjithashtu edhe forma tjera të shprehjeve si për shembull filmat, artet, gjestet (gjuha simbolike).”

Burimi: Asociacioni Evropian për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Gjuha Urrejtëse, (shiko: www.aedh.eu/plugins/fckeditor/userfiles/file/Discriminations%20et%20droits%20des%20minorités/Hate%20speech.pdf)

“Çfarëdo avokimi i urrejtjes nacionale, racore apo fetare që paraqet nxitje për diskriminim, armiqësi apo dhunë do të ndalohej me ligj.”

Burimi: Kombet e Bashkuara, Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, Neni 20 (2), (shiko: www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/ccpr.aspx)

Figura 1- Perkufizime te ndryshme te "Gjuhes se Urrejtjes"

Burimi: (Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore, 2016)

2.3 Legjislacioni Mbrojtës

Duke marrë parasysh rëndësinë që ka shmangia dhe reduktimi sa më shumë të jetë e mundur e nxitjes dhe gjuhës së urrejtjes së përdorur në mjetet e komunikimit masiv online, disa shtete zgjedhin të ngrejne institucione publike posacërisht për mbikqyrjen e përdorimit të mjeteve të komunikimit, përfshirë këtu edhe gjuhën e përdorur. Prsh. Shqipëria ka institucionin Autoriteti i Medias Audiovizive (AMA) e cila në mënyrë të vazhdueshme monitoron përdorimin e mediave audivizive dhe ndërhyt në raste abuzimesh. Së fundmi, me krijimin e departamentit të Këshillit të Ankesave që operon pranë këtij institucioni, lufta ndaj gjuhës së urrejtjes është bërë me e lehtë, pasi kushdo mund të ankohej pranë Këshillit të Ankesave për cdo shkelje, abuzime, fyerje, gjuhë urrejtjeje apo nxitje urrejtjeje e përdorur në mjetet e komunikimit masiv në Shqipëri.

Në Kosovë është ngritur një organizatë qeveritare e quajtur “ Komuniteti Per Siguri Kibernetike Dhe Privatësi”, e cila angazhohet në identifikimin, analizimin e lajmeve të reja dhe ato të cilat përmbajnë shkelje, abuzime dhe përdorim të gjuhës së urrejtjes.

(shiko: <https://telegrafi.com/per-dy-dite-ne-prishtine-po-mbahet-konferenca-e-madhe-rajonale-per-siguri-kibernetike-foto/>).

Por duke qenë se rrjetet sociale tashme i kanë thyer barrierat gjeografike, duke tejkaluar cdo komb dhe kontinent, legjislacioni i një shteti është paksa e vështirë të aplikohet dhe të ndërhyjë në legjislacionin e një shteti tjetër. Për këtë arsye janë krijuar mjaft traktate dhe konventa ndërkombëtare për mbrojtjen nga “gjuha e urrejtjes” të cilat me ratifikimin e tyre nga shtetet përkatëse, marrin fuqi zbatuese në cdo shtet ratifikues. Ndër më të rëndësishmet mund të përmenden: Konventa për Krimin Kibernetik; Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut; Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR) i cili shprehet se “*çdo mbrojtje e urrejtjes kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitje të diskriminimit, armiqësisë ose dhunës do të ndalohet me ligj*”; Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (ICERD) e cila ndalon çdo nxitje të racizmit; të gjitha të hartuara nga Këshilli i Europës, për një legjislacion më të unifikuar dhe të harmonizuar. Në vitin 2018, Kombet e Bashkuara (KB) nxorren Strategjinë dhe Planin e Veprimit të KB për Gjuhën e Urrejtjes (Parlamenti European, 2020).

Por duke qenë se numri i abuzimeve me gjuhën e urrejtjes në rrjete sociale ishte ende i lartë, atëherë iu vendos kompanive të rrjeteve sociale kriter detyrues-shtrëngues aplikimi i politikave më të rrepta ndaj gjuhës së përdorur dhe kontrolli i vazhdueshëm i saj kundrejt përdoruesve.

Adresimi i gjuhës së urrejtjes në mediat sociale konsiderohet paksa e vështirë. Ai përfshin tre grupe të së drejtës së shprehjes që duhet të merren parasysh ndërsa vendosen kufizime në rrjetet sociale: të drejtat e individëve që shprehin mendimin, të drejtat e platformave të rrjeteve sociale dhe palës së tretë.

Në 2013, Facebook, me presion nga mbi 100 grupe sindikatash dhe studio ligjore, përfshirë Projektin e Përditshëm të Seksizmit, ranë dakord të ndryshojnë politikat e tyre të gjuhës së urrejtjes, pasi të dhënat e lëshuara në lidhje me përmbajtjen që promovonte dhunën në familje

dhe seksuale ndaj grave çuan në tërheqjen e reklamave nga 15 kompani të mëdhaja (shiko:<https://www.theguardian.com/technology/2013/may/29/facebook-campaign-violence-against-women?CMP=EMCNEWEML6619I2>)

Më 31 maj 2016, Facebook, Google, Microsoft dhe Twitter, ranë dakord së bashku për një kod të sjelljes të Bashkimit Evropian që i detyron ata të rishikojnë "shumicën e njoftimeve të vlefshme për heqjen e gjuhës së paligjshme të urrejtjes" të postuar në shërbimet e tyre brenda 24 orëve (shiko:<https://www.theguardian.com/technology/2016/may/31/facebook-youtube-twitter-microsoft-eu-hate-speech-code>).

<p>Kushtetuta e Republikës së Kosovës</p>	<p>Neni 40 Liria e Shprehjes</p> <p>2. Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.</p> <p>Neni 42 Liria e Mediave</p> <p>2. Censura është e ndaluar. Askush nuk mund të pengojë shpërndarjen e informacionit ose të ideve nëpërmjet mediave, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.</p> <p>Neni 44 Liria e Asociimit</p> <p>3. Organizatat ose aktivitetet që kanë për qëllim cenimin e rendit kushtetues, shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut, ose nxitjen e urrejtjes racore, kombëtare, etnike a fetare, mund të ndalohen me vendim gjyqësor të gjykatës kompetente.</p>
	<p>Neni 33 Veprimet e Ndaluar të Subjekteve</p>

<p>Ligji për zgjedhjet e përgjithshme (03/L-073)</p>	<p>Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: [...] l) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë; [Kjo shkelje gjohet me 10,000 deri në 30,000 Euro sipas rregullores 01/2012 të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa] [...]</p> <p>Neni 34 Frikësimi dhe Dhuna Gjatë Procesit Zgjedhor</p> <p>34.1 Përdorimi ose kërcënimet me përdorim të dhunës së çfarëdo lloji nga subjekti politik, anëtarët, mbështetësit ose kandidatët e tyre, ndalohet rreptësisht.</p> <p>34.2 Asnjë subjekt politik ose kandidatët nuk inkurajojnë, mbështesin ose miratojnë dhunën, kërcënimet me dhunë ose kanosje, gjatë procesit zgjedhor. Secili subjekt politik i informon anëtarët dhe mbështetësit e tij për nevojën për të shmangur një sjellje të tillë.</p> <p>34.3 Fushata zgjedhore organizohet në atë mënyrë që një atmosferë e pëlqyeshme dhe paqësore të mbizotërojë gjatë fushatës zgjedhore.</p>
<p>Kodi Penal i Republikës së Kosovës</p>	<p>Neni 147 Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik</p> <p>1. Kushdo që nxit ose përhap publikisht urrejtje, përçarje ose mos durim midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike apo grupe tjera të tilla që jetojnë në Republikën e Kosovës, në mënyrën e cila mund të prishë rendin publik, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet. [...]</p>

Figura 2- Legjislacioni i Kosovës mbi lirinë e shprehjes dhe gjuhës së urrejtjes

Burimi: (Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore, 2016)

2.4 Format më të përhapura të gjuhës së urrejtjes

Urrejtja mund të përhapet dhe të nxitet si nga individët ashtu dhe nga grupet. Autorët e gjuhës së urrejtjes në mediat online nuk kanë viktima specifike. Përvoja tregon se grupet më të zakonshme kundër të cilave drejtohet gjuha e urrejtjes janë refugjatët dhe imigrantët, si dhe pakicat fetare, etnike. Grupe të tilla janë të marginalizuara dhe sulmet terroriste dhe sjelljet e gabuara të individëve që i përkasin grupeve të caktuara të pakicave shpesh instrumentalizohen për të minuar imazhin publik të njerëzve në nevojë (Gelashvili, 2018, p. 44)

Forma kryesore e urrejtjes e praktikuar zakonisht është shprehja e drejtpërdrejtë e ideve negative ndaj grupeve të synuara. Në këtë rast, përdoruesit adresojnë në mënyrë specifike grupe të caktuara dhe përhapin ide që nxisin armiqësi ndaj tyre. Kjo mund të ilustruhet me rastin e grupit publik në Facebook i quajtur "Kick a Ginger Day" (Dita e të qëlluarit një Ginger). Gjuha e urrejtjes e përdorur në këtë grup kundërt flokkuqëve ka inkurajuar sulme fizike ndaj studentëve me flokë të kuq, dhe si pasojë, kanë ndodhur sulme të tilla fizike (Citron, 2011). Gjithashtu, në 2010, një grup tjetër në Facebook i quajtur "Kill a Jew Day" (Dita e të vrarit një Hebre) publikonte postime të vazhdueshme më përdorime të gjuhës së urrejtjes dhe me përmbajtje të cilat nxisnin dhe inkurajonin dhunën ndaj hebrenjve. Përdoruesit komentonin se mezi prisnin të përdhunonin foshnjën e vdekur hebre (po aty). Të dy faqet u hoqën më pas nga administrata e Facebook.

Një studim i realizuar nga organizata Pro-LGBT në bashkëpunim me ambasadën gjermane në Shqipëri i cili monitoroi 109 emisione televizive dhe 293 artikuj të medias së shkruar në periudhën mars-gusht 2020. Monitorimi tregoi se kategoritë më të targetuara në Shqipëri janë gratë, të ndjekura nga komuniteti Rom dhe Egjiptian, komuniteti LGBT, komunitetet fetare si edhe personat me aftësi të kufizuar. Gjithashtu, një rezultat tjetër i studimit ishte se në emisionet televizive, rreth 73% e të ftuarve janë burra, ndërsa vetëm 27% e tyre janë gra.

Avokatja e Popullit, Erinda Ballanca e krahasoi gjuhën e urrejtjes si “një virus që godet shoqërinë” dhe kritikoi përfaqësuesit e medias, të politikës apo edhe të botës së artit që e përcojnë atë. *“Fatkeqësisht, për problemin e gjuhës së urrejtjes nuk jemi duke gjetur një zgjidhje, pasi lufta ndaj këtij fenomeni do të sillte një zgjidhje edhe në ndalimin e fenomenit ku tregohen me gisht persona të cilët kanë prirje të ndryshme apo mendojnë ndryshe nga ne”*, vijoi avokatja Ballanca. (shiko: <https://www.reporter.al/gjuha-e-urrejtjes-ne-media-targeton-grate-dhe-komunitetet-e-margjinalizuara/>).

Autori i studimit të mesiperm, Emiljano Kaziaj, e shpjegon këtë fenomen: *“Ajo që kemi vënë re në të dyja monitorimet, si me median online ashtu edhe me atë televizive, është se për të arritur artikuj sensacionalë dhe sa më shumë klikime apo audiencë, mediat nuk respektojnë ligjet që ekzistojnë kundra diskriminimit,” u shpreh Emiljano Kaziaj gjatë prezantimit online”*

Përdorimi i gjuhës së urrejtjes dhe nxitjes në mediat online përfshin forma dhe kategori të ndryshme, por ato më të përhapurat gjenden si më poshte:

- **Gjuha e urrejtjes gjinore**

Kjo kategori përfshin çdo formë të armiqësisë ndaj gjinisë së veçantë ose çfarëdo zhvlerësimi të bazuar mbi gjininë e personit. Kjo përfshin çdo postim që shkel gjininë e veçantë. Gjithashtu përfshin çdo formë të mizogjinisë (urrejtja ndaj femrës).

Sipas raportit të Komisionit të Broadband të Kombeve të Bashkuara për vitin 2015, 73% e grave abuzohen në internet në të gjithë botën (UN BROADBAND COMMISSION , 2015)

E lidhur ngushtësisht me gjuhën e urrejtjes me bazë gjinore është edhe gjuha e urrejtjes seksiste. Ajo konsiston me shprehjet që përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen bazuar në seks. Disa grupe grash janë veçanërisht të shënjestruara nga gjuha e urrejtjes seksiste (veçanërisht gratë e reja, gratë në media ose gratë politike), por çdo grua dhe vajzë është një shënjestër e mundshme për gjuhë urrejtje seksiste në internet dhe jashtë

linje. Disponueshmëria në rritje dhe përdorimi i internetit dhe platformave sociale kanë kontribuar në shfaqjen në rritje të gjuhës seksuale të urrejtjes.

(shiko: <https://www.coe.int/en/web/genderequality/sexist-hate-speech>)

- **Gjuha e urrejtjes raciste**

Së fundmi, kjo kategori përfshin: çdo lloj ofendimi racor ose fisnor, rajonalizmi, ksenofobia (veçanërisht për punëtorët migrantë) dhe nativizmit (armiqësi kundër emigrantëve dhe refugjatëve) dhe çdo paragjykimi ndaj një fisi ose rajoni të veçantë. Për shembull, ofendimi i një individi sepse ai i përket një fisi ose rajoni ose vendi të caktuar ose favorizimi i një fisi të veçantë. Gjithashtu edhe ofendimi për shkak të pamjes apo ngjyrës së individit përfshihet në këtë kategori të përdorimit të gjuhës së urrejtjes (Al Hassan & Al-Dossari, 2019).

Në formën e tij më të njohur, gjuha e urrejtjes bën pretendimin se anëtarët e një grupi racor ose të një grupi tjetër të identifikueshëm janë më pak njerëzorë ose më pak të denjë se të tjerët ose se ndajnë një tipar të rrezikshëm ose të padëshirueshëm.

- **Gjuha e urrejtjes fetare**

Kjo kategori përfshin çdo lloj diskriminimi fetar, të tilla si: sekte islamike, thirrje për ateizëm, thirrjet anti-krishterë dhe konfesionet e tyre përkatëse ose anti-hinduizëm dhe fe të tjera. Në vendet me krime më të larta shoqërore, gjuha e urrejtjes fetare konsiderohet si motiv i krimeve (Albadi, Kurdi, & Mishra, 2018).

Gjuha e urrejtjes e drejtuar kundër një grupi fetar shpesh merr formën standarde të gjuhës së urrejtjes racore, duke u atribuar në mënyrë të gabuar tipare të tilla si pandershmëri ose mizori anëtarëve të grupit. Si shembull, antisemitizmi, të paktën në epokën moderne, ka marrë përgjithësisht këtë formë, duke përfshirë pretendime për karakteristikat e padëshirueshme të hebrenjve (shiko: <https://tif.ssrc.org/2019/01/18/religion-and-hate-speech/>).

Marrëdhënia midis fesë dhe gjuhës së urrejtjes është komplekse. Nga njëra anë, ajo ka qenë thelbësore për diskutimet e fundit të gjuhës së urrejtjes drejtuar njerëzve fetarë, veçanërisht anëtarëve të pakicave fetare. Nga ana tjetër, besimtarët fetarë ndonjëherë mbrojnë përdorimin e tyre të gjuhës së urrejtjes kundër anëtarëve të besimeve të tjera fetare, ose njerëzve me një orientim të caktuar seksual, si pjesë e lirisë së tyre fetare. Shembujt e fundit përfshijnë

pëlqimin e pastorit suedez Aaka Green të homoseksualëve me “kancer”; vërejtjet antisemitike të predikuesit tunizian Muhamed Hamamami; dhe përshkrimi i Islamit nga Pastori i Belfastit James McConnell duke e referuar si "pagan" dhe "Satanik". Kjo e bën veçanërisht të rëndësishme një shqyrtim të marrëdhënies midis gjuhës së urrejtjes dhe fesë. (Bonotti, 2017).

Gjuha e urrejtjes, kur drejtohet ndaj një grupi fetar, siç janë myslimanët prsh, i atribuon një besim të padëshirueshëm ose të rrezikshëm grupit në tërësi dhe e trajton besimin si një aspekt të botëkuptimit të secilit besimtar. Fjalimi injoron shumëllojshmërinë e besimit brenda grupit dhe zhdok hapësirën midis individit dhe grupit fetar ose traditës me të cilën ata identifikohen (shiko: <https://tif.ssrc.org/2019/01/18/religion-and-hate-speech/>).

2.5 Ndikimi i përdorimit të gjuhës së urrejtjes online

Gjuha e urrejtjes përfshin shumë forma të shprehjeve të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen, dhunën dhe diskriminimin ndaj një personi ose një grupi personash për një larmi arsyesh (shiko: [https://www.coe.int/en/web/european-commission-against-racism-and-intolerance/hate-speech-and-](https://www.coe.int/en/web/european-commission-against-racism-and-intolerance/hate-speech-and-violence#:~:text=Hate%20speech%20covers%20many%20forms,and%20the%20rule%20of%20law.)

[violence#:~:text=Hate%20speech%20covers%20many%20forms,and%20the%20rule%20of%20law.](https://www.coe.int/en/web/european-commission-against-racism-and-intolerance/hate-speech-and-violence#:~:text=Hate%20speech%20covers%20many%20forms,and%20the%20rule%20of%20law.)) Përdorimi i gjerë i internetit si dhe zhvillimet e vazhdueshme teknologjike dhe të mjeteve të komunikimit kanë mundësuar përdorimin sa më të lire e të pakufizuar të gjuhës së komunikimit, e cila nëse nuk përdoret në mënyrën e duhur, mund të ketë pasoja të mëdha. Përdorimi i gjuhës së urrejtjes paraqet rreziqe të mëdha për kohezionin e një shoqërie demokratike, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit.

Shkenca mbështet idenë se përdorimi i gjuhës së urrejtjes mund të shkaktojë plagë më të thella sesa ndjenjat e lënduara në të dy nivelet: shoqërore dhe personale. Kërkimet neurologjike dhe sociologjike kanë vërtetuar se gjuha e urrejtjes çon në ‘një efekt dehumanizues’ i cili zvogëlon ndjeshmërinë tonë për njerëzit e tjerë (shiko: <https://impakter.com/hurt-feelings-real-danger-hate-speech/#:~:text=Science%20backs%20up%20the%20idea,our%20empathy%20for%20other%20people.>)

Sipas një studimi të kryer nga (Saha, Chandrasekharan, & De Choudhury, 2019) përdorimi i gjuhës së urrejtjes në kolegje apo kampuse shkollore sjell pasoja negative dhe është veçanërisht i dëmshëm në komunitetet e të rinjve. Përpjekjet për të rregulluar përdorimin e gjuhës së urrejtjes në kampuset e kolegjit paraqesin probleme socio-politike shqetësuese. Sipas studimit, ekspozimi ndaj gjuhës së urrejtjes çon në shprehje dhe nivele më të larta të stresit. Sidoqoftë, jo të gjithë të ekspozuarit preken njësoj; disa tregojnë qëndresë më të ulët psikologjike se të tjerët. Individët me qëndrueshmëri të ulët janë më të prekshëm nga shpërthimet emocionale dhe janë më neurotikë sesa ata me qëndresë më të lartë.

Edhe në Kosovë përdorimi i gjuhës së urrejtjes me komente që nxisin urrejtje fetare, racore dhe gjinore janë të pranishme, sic shprehet znj. Luljeta Aliu, drejtoreshë në organizatën joqeveritare“ Iniciativa për Drejtësi dhe Barazi-Inject.

(shiko:<https://www.evropaelire.org/a/30101463.html>).

Me një fokus të vecantë ndaj diskriminit gjinor dhe urrejtjes ndaj grave që shprehet në mënyrë masive në mediat online, znj, Aliu shprehet se është një fenomen mjaft shqetësues. Vërtet njerëzit kanë liri në shprehjen e mendimit, por kjo nuk do të thotë që duhet të diskriminojnë dhe “masakrojnë” me komente gjininë femërore, duke nxitur në këtë mënyrë urrejtje masive. Një shembull i kohëve të fundit, që përmendet nga znj. Aliu, ishte rasti i gruas rome e cila u diskriminua, u përfol dhe u sulmua masivisht në mediat online duke përdorur gjuhë urrejtje e duke e klasifikuar si “rrëmbyese fëmijësh” pa baza dhe fakte të vërteta, coi në dhunën fizike të ushtruar ndaj saj nga një grup të rinjsh (po aty).

Mbështetur edhe nga psikologjia Mira Gashi Aziri, në një intervistë për Radio Evropa e Lirë: *“Gjuha e urrejtjes mund të them që është e shprehur tashmë shumë në rrjetet sociale, duke e ditur se nuk sanksionohen dhe nuk ndëshkohen me ligj secili e shpreh urrejtjen më lirshëm duke targetuar në këtë rast gratë, apo grupe të caktuara shoqërore. Gjuha e urrejtjes mund të nxis edhe dhunë”*

(shiko: <https://www.evropaelire.org/a/30101463.html>)

Sipas një studimi të kryer në Kosovë nga Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore, mbështetur nga USAID, i cili hulumton ndikimin e mundshëm të gjuhës së urrejtjes në politikë mbi rininë e Kosovës, pjesëmarrësit pohuan se gjuha e urrejtjes është shumë më e pranishme aktualisht, dhe se janë të ekspozuar ndaj kësaj gjuhe çdo ditë në lajme, debate televizive, protesta dhe rrjete sociale (Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore, 2016). Si rezultat i studimit, pjesëmarrësit besonin se gjuha e urrejtjes ka ndikim negativ mbi shoqërinë dhe sidomos mbi të rinjtë dhe personat që jetojnë në kushte të varfra ekonomike. Kryesisht, pjesëmarrësit dënuan përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe kryesisht nuk mbështesin politikanët të cilët përdorin gjuhë të urrejtjes (po aty).

Në studimin e realizuar nga organizata Pro-LGBT në bashkëpunim me ambasadën gjermane në Shqipëri, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda tha se përdorimi i gjuhës së urrejtjes në formatet televizive nga vetë politikanët apo figurat e njohura dhe njerëz me peshë në opinionin publik, krijon modelet e gabuara dhe nxit përforcimin e diskriminimit dhe stereotipeve ndaj grupeve vulnerabel në shoqëri.

“Fakti për të ardhur keq qëndron se personat të cilët e përdorin gjuhën e urrejtjes në media nuk ndërgjegjësohen dhe nuk kërkojnë ndjesë për akte të tilla, por në të kundërt ata preferojnë të gjobiten, gjë e cila është shqetësuese pasi tregon se këta individë nuk janë të ndërgjegjshëm për dëmin që ato po shkaktojnë nëpërmjet përdorimit të kësaj gjuhe,” tha komisioneri Gajda (shiko: <https://www.reporter.al/gjuha-e-urrejtjes-ne-media-targeton-grate-dhe-komunitetet-e-margjinalizuara/>).

3. DEKLARIMI I PROBLEMIT

3.1 Qëllimi i Punimit dhe Pyetja Kërkimore

Ky punim ka si qëllim kryesor të studiojë ndikimin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes në mediat e shkruara elektronike në Prishtinë, Kosovë. Punimi i kësaj teme u nxit duke marrë parasysh rëndësinë dhe kompleksitetin që kjo teme paraqet, mungesën e informacionit dhe studimeve në këtë fushë në Kosovë, si dhe rëndësinë që ka informimi i duhur i qytetarëve për ndikimet që vijnë nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes në mediat online.

Për këtë arsye pyetja kërkimore e këtij punimi është:

P.K: Cilat janë pasojat e përdorimit dhe nxitjes së gjuhës së urrejtjes në mediat e shkruara elektronike në Prishtinë, Kosovë?

3.2 Objektivat e Punimit

- Te informojë lidhur me fenomenin e përdorimit dhe nxitjes së gjuhës së urrejtjes në mediat e shkruara elektronike
- Të shpjegojë rëndësinë që ka studimi i këtij fenomeni
- Të japë një shpjegim të përmblendhur të historisë së lindjes së fenomenit, shpjegimin e terminologjive kryesore dhe ndikimet e përgjithshme
- Të analizojë ndikimet dhe pasojat që ka përdorimi dhe nxitja e gjuhës së urrejtjes në mediat e shkruara elektronike në Prishtinë, Kosovë
- Të ndërrojë masën lidhur me problematikën me qëllim reduktimin e saj

4. METODOLOGJIA

Metodologjia e kërkimit në një punim përfshin metodat ose teknikat specifike të përdorura për të identifikuar, përzgjedhur, përpunuar dhe analizuar informacionin në lidhje me temën. Pjesa hulumtuese i referohet pyetjes "si" përgjatë çdo pjese të fazës së hulumtimit. Më konkretisht, ka të bëjë me atë se si një studiues harton sistematikisht një studim për të siguruar rezultate të vlefshme dhe të besueshme që adresojnë qëllimet dhe objektivat e hulumtimit (Holden, 2004).

4.1 Qasja Kërkimore

Ky punim synon të jetë eksplorativ dhe përshkrues. Duke qenë se ky punim synon të studiojë ndikimin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes dhe nxitjes në mediat online në Kosovë, një fushë e cila nuk është studiuar ende, atëhere është zgjedhur si qasje kërkimore natyra eksplorative. Kjo pasi studimet eksplorative kryhen për të kuptuar më mirë problemin ekzistues dhe janë procese të hetimit të një problemi që nuk është studiuar ose hetuar hollësisht në të kaluarën (Stebbins, 2001).

Natyra përshkruese e punimit lidhet kryesisht me mënyrën e të shpjeguarit dhe interpretuarit të të dhënave, rezultateve, fakteve.

4.2 Dizajni Kërkimor

Dizajni kërkimor i këtij punimi mbështetet në një kombinim burimesh primare dhe sekondare. Burimet dytësore, të cilat konsistojnë më shumë në informacione të marrë nga librat, interneti, artikuj shkencorë, etj, pra burime të gatshme e të botuara në faqe të besueshme, krijojnë bazën teorike të këtij punimi. Ndërsa burimet primare të përzgjedhura, të cilat konsistojnë në studime të mirëfillta të kryera nga vetë autorja e këtij punimi, i japin përgjigje pyetjes kërkimore të studimit.

Në vijëmbësi, ky punim do jetë kualitativ dhe kuantitativ. Të dhënat e përfituara nga burimet primare, të analizuar në formë statistikore, do interpretohen me anë të metodave kualitative, në mënyrë që lexuesi të kuptojë me qartë dhe thjeshtë rezultatet e punimit.

4.3 Teknika E Mbledhjes Së Të Dhenave

Si metodë kërkimore e burimeve primare për këtë punim është përzgjedhur sondazhi. Kjo pasi sondazhi jep mundësinë për të marrë informacion nga një mostër relativisht e madhe në kohë më të shkurtër dhe me kosto më të ulët sesa metodat e tjera të hulumtimit. Për më tepër, ato ofrojnë fleksibilitet në strukturimin e pyetësorit dhe janë më të lehta për t'u administruar si dhe për të interpretuar rezultatet (Chrysochou, 2017, p. 422).

Sondazhi, si metodë kërkimore, është realizuar me anë të shpërndarjes së anketave/pyetësorëve gjysëm të strukturuar për të realizuar grumbullimin e të dhënave, pasi anketat konsiderohen si metoda më e zakonshme për të mbledhur të dhëna sasiore duke u referuar ndryshe si intervista kërkimore sasiore (Saunders, Lewis, & Thornhill, 2007, p. 356).

Anketat janë strukturuar kryesisht me pyetje me alternativa ose pyetje në shkallën Likert pasi janë më të lehta për tu procesuar, analizuar si dhe shmangin subjektivitetin nga ana e autorit në procesimin e rezultateve. Gjithashtu ka patur edhe pyetje të hapura brënda opsioneve të alternativave për t'ju dhënë mundësi të anketuarëve të japin mendimin e tyre subjektiv, pa u limituar në përgjigje.

Anketat iu janë shpërndarë 50 qytetarëve të ndryshëm në qytetin e Prishtinës, Kosovë. Të anketuarit janë përzgjedhur rastësisht, kryesisht midis moshave 18-50 vjeç, duke besuar se ky interval moshe do ta kuptonte më mirë qëllimin e sondazhit; do jetë më i familjarizuar me përdorimin e mediave online dhe rrjedhimisht përgjigjet do jenë më të sakta.

4.4 Çështjet Etike

Ky punim ka marrë në konsideratë çështje kryesore etike të tilla si mos plagjiarizimi i punës së të tjerëve, citimi i duhur si dhe botimi i rezultateve në mënyrë transparente.

Përsa i përket pjesës së anketimit, të anketuarëve iu është prezantuar fillimisht qëllimi i punimit, objektivat e hulumtimit dhe iu është shpjeguar se si do të përdoren rezultatet e pyetësorëve. Së fundmi identiteti i të anketuarëve është ruajtur anonim në kuadër të respektimit të konfidencialitetit dhe privatësisë së pjesëmarrësve.

5. PREZANTIMI I REZULTATEVE

5.1 Aspekte të Përgjithshme të Pjesëmarrësve

Në bazë të rezultateve të përftuara, 31% e pjesëmarrësve i përkasin grupmoshën 18-24 vjec; 29% i përkasin grupmoshës 25-35 vjec; 21% 36-45 vjec; 12% 45-55 dhe vetëm 7% i përkasin grupmoshës 55+ vjec.




Figura 3- Grupmosha e pjesëmarrësve

Lidhur me gjininë e pjesëmarrësve, 64% i përkasin gjinisë femërore e ndërsa 36% i përkasin gjinisë mashkullore.

Të pyetur lidhur me përdorimin e mjeteve të komunikimit online, rezulton se 96% e pjesëmarrësve i përdorin mjetet e komunikimit online e vetëm 4% nuk i përdorin ato (figura 4).



Figura 4- Përdorimi i mjeteve të komunikimit online nga pjesëmarrësit

Lidhur me okupimin, rezultoi se 46% janë studentë, 37% të punësuar, 11% shtëpiakë, dhe 6% kishin përzgjedhur opsionin “Tjetër” duke përcaktuar në mënyrë subjektive okupimin e tyre (figura 5).




Figura 5- Okupimi i pjesëmarrësve

5.2 Aspekte Specifike të Pjesëmarrësve

Pavarisht se në formatin e anketimit, në pjesën hyrëse, pjesëmarrësve iu është bërë prezantimi me terminologjinë dhe kuptimin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes dhe nxitjes së saj në mediat online, ashtu si edhe është ilustruar me shembuj, rezulton se 76% e pjesëmarrësve arrijnë ta kuptojnë cdo të thotë përdorim dhe nxitje të gjuhës së urrejtjes në mediat online; 18% Nuk janë shumë të sigurtë ndërsa vetëm 6% nuk arrijnë ta kuptojnë terminologjinë (figura 6).




Figura 6- Kuptimi i gjuhës së urrejtjes nga pjesëmarrësit

Për të kuptuar më mirë natyrën e pjesëmarrësve, janë pyetur nëse kanë përdorur apo nxitur, qoftë edhe pa qëllim, gjuhë të urrejtjes në mediat online. Rezulton se vetëm 4% kanë përdorur gjuhë të urrejtjes; 18% Mbase e ndërsa 49% Jo; 29% Absolutisht Jo e 18% (figura 7).




Figura 7- Përdorimi i gjuhës së urrejtjes nga pjesëmarrësit

Më pas pjesëmarrësit janë pyetur nëse kanë rënë ndonjëherë pre e gjuhës së urrejtjes në mediat online. Nga anketimi rezulton se 42% janë prekur nga gjuha e urrejtjes në mediat online; 32% Jo e 26% janë përgjigjur Nuk e di. Kuptojmë se numri i të prekurëve nga përdorimi dhe nxitja e gjuhës së urrejtjes në mediat online është relativisht i lartë. Gjithashtu te 26% që janë përgjigjur “Nuk e di” ekziston probabiliteti që të kenë rënë pre e gjuhës së urrejtjes në mediat online, të paktën 1 here, por të mos e kenë kuptuar plotësisht, por e cila lë gjurmë të thella që mund të shfaqen në moment të mëvonshëm (figura 8).




Figura 8- Pjesëmarrësit pre e gjuhës së urrejtës në mediat online

Në vijë mësi, pjesëmarrësit që u përgjigjën Po, u pyetën së në cilat media online e kanë përjetuar më shumë gjuhën e urrejtjes. Rezulton se 64% e pjesëmarrësve kanë përjetuar gjuhën e urrejtjes më shumë në rrjete sociale (facebook, instagram, twitter etj); 25% në portale mediatike; 5% në Portale Akademike, 2% në Website e platforma të ngjashme e 4% kanë zgjedhur Tjetër (figura 9)




Figura 9- Mediat e shkruara më të shpeshta të përdorimit të gjuhës së urrejtjes

Për më tepër, pjesëmarrësit që u përgjigjën “Po” pyetjes së përjetimit të gjuhës së urrejtjes në mediat online, u pyetën lidhur me ndikimin që ky përjetim ka patur tek to, në varësi të alternativave të propozuara, por gjithashtu duke lënë edhe opsionin “Tjetër” ku pjesëmarrësit mund të shkruanin në mënyrë subjektive cdo përjetim tjetër.

38% janë shprehur se përjetimi i gjuhës së urrejtjes në mediat online ka patur Ndikim Psikologjik tek to; 29% Ndikim shpirtëror; 10% Ndikim Fizik; 15% kanë zgjedhur Të gjitha bashke; 6% shprehen se nuk kanë patur ndikim e vetëm 2% kanë zgjedhur opsionin Tjetër duke dhënë opsione si: depression, ulje e moralit, prishje të humorit, etj (figura 10).

Nëse po, cfarë ndikimi pati tek ju?




Figura 10- Ndikimi i përjetimit të gjuhës së urrejtjes në mediat online

Me qëllimin edhe për t'ju përgjigjur pyetjes kërkimore të këtij punimi: Cilat janë pasojat e përdorimit dhe nxitjes së gjuhës së urrejtjes në mediat online, pjesëmarrësit u pyetën lidhur me pasojat që mund të kenë patur ato apo persona të njohur të tyre. Sipas rezultateve të sondazhit, 35% raportojnë “mbyllje në vetvete” të personit të sulmuar në mediat online nga gjuha e urrejtjes; ndjekur ngushtësisht nga pasoja e “rënies së vetëbesimit” me 29%; 17% kanë shfaqur “sjellje agresive”; 14% kanë pohuar se i kanë parë të pranishme “ të gjitha” këto pasoja; e ndërsa 5% kanë zgjedhur opsionin “Tjetër” duke argumentuar pasoja të ndryshme, ku më të shpeshtat ishin: rebelizëm, rënie në peshë, mungesë oreksi etj (figura 11)

Cfarë pasojash ka patur përdorimi i gjuhës së urrejtjes në mediat online (tek ju apo tek ndonjë person i njohur)?




Figura 11- Pasojat e përdorimit të gjuhës së urrejtjes në mediat online

6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Përdorimi i mjeteve të komunikimit online ka shfaqur avantazhe të panumërta lidhur me përhapjen e informacionit drejt një audiencë më të gjërë duke tejkaluar kufijtë gjeografikë si dhe me kosto të ulët ekonomike. Por ndoshta për shkak të natyrës demokratike të përdorimit të rrjeteve sociale, liria e shprehjes në mjetet e komunikimit online vërehet të përdoret e pakufizuar dhe e pakontrolluar. Ky fenomen i ka dhënë hov edhe krijimit të llogarive të ndryshme online që përvec se shfaqin një gjuhë urrejtje ndaj një grupi të caktuar për arsye politike, etnike, gjinore, racore, orientimit seksual etj, ato gjithashtu nxisin frymen e urrejtjes ndaj ketyre grupeve. Grupet e përndjekura online, ndaj të cilëve aplikohet gjuha e urrejtjes dhe nxitja për urrejtje në rrjetet sociale, mund të pësojnë dëmtime të mëdha psikologjike, shpirtërore por edhe fizike, si në rastet kur nxitja në rrjetet sociale është aq e madhe sa që këto individë mund të përndiqen edhe fizikisht.

Gjuha e urrejtjes e përdorur në mediat online vështirë se mbetet pa u vënë re. Përmbajtjet që përfshijnë mesazhe të urrejtjes variojnë nga "sulmo një femër" në "vrit një homoseksual" dhe mund të synojnë këdo, pavarësisht nga statusi, gjinia, vendndodhja e kështu me radhë. Edhe në rastet kur gjuha e urrejtjes nuk materializohet në një krim të motivuar nga urrejtja, sërisht konsiderohet të jetë shkaktuar dëm.

Termi "gjuhë e urrejtjes", përkufizuar nga Këshilli Europës, do të kuptohet si mbulim i të gjitha formave të shprehjes që "*përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen racore, ksenofobinë, antisemitizmin ose forma të tjera të urrejtjes bazuar në intolerancë, përfshirë intolerancën e shprehur nga nacionalizmi agresiv dhe etnocentrizmi, diskriminimi dhe armiqësia kundër pakicave, migrantëve dhe njerëzve me origjinë emigrante*".

Ky studim pati për qëllim kryesor të zbulojë efektet e përdorimit dhe nxitjes së gjuhës së urrejtjes në mediat online. Për t'iu përgjigur pyetjes kërkimore, si metodë hulumtuese është përzgjedhur sondazhi, me anë të shpërndarjes së 50 anketave në qytetin e Prishtinës. Anketat janë shpërndarë në mënyrë rastësore, duke synuar kryesisht grupmoshën 18-55 vjec, duke besuar se ky interval moshe do ta kuptonte më mirë qëllimin e sondazhit; do jetë më i familjarizuar me përdorimin e mediave online dhe rrjedhimisht përgjigjet do jenë më të sakta.

Sipas analizimit të të dhënave të sondazhit, rezultoi se 42% janë prekur nga gjuha e urrejtjes në mediat online. Nga ato pjesëmarrës që janë prekur, 64% e kanë përjetuar gjuhën e urrejtjes më shumë në rrjete sociale (facebook, instagram, twitter etj) e ndërsa 25% në portale mediatike.

Lidhur me ndikimin e gjuhës së urrejtjes në mediat online, nga pjesëmarrësit e prekur, 38% janë shprehur se përjetimi i gjuhës së urrejtjes në mediat online ka patur Ndikim Psikologjik tek to; 29% Ndikim shpirtëror; 10% Ndikim Fizik; 15% kanë zgjedhur Të gjitha bashke.

Me qëllimin edhe për t'ju përgjigjur pyetjes kërkimore të këtij punimi: Cilat janë pasojat e përdorimit dhe nxitjes së gjuhës së urrejtjes në mediat online, pjesëmarrësit u pyetën lidhur me pasojat që mund të kenë patur ato apo persona të njohur të tyre. Sipas rezultateve të sondazhit, 35% raportojnë “mbyllje në vetvete” të personit të sulmuar në mediat online nga gjuha e urrejtjes; ndjekur ngushtësisht nga pasoja e “rënies së vetëbesimit” me 29%; 17% kanë shfaqur “sjellje agresive”; 14% kanë pohuar se i kanë parë të pranishme “ të gjitha” këto pasoja.

Si përfundim, arrijmë të kuptojmë se përdorimi dhe nxitja e gjuhës së urrejtjes në mediat online ka ndikim të thellë psikologjik, shpirtëror por edhe fizik në disa raste, e gjithashtu shoqërohet me pasoja të mëtejshme të rënda. Vërtet cdo njeri gëzon lirinë e fjalës, shprehjes dhe mendimit, e drejtë themelore e individit parashikuar edhe nga Kushtetuta e cdo shteti. Por gjuha ndonjëherë mund të jetë një “armë” e ftohtë e cila mund të shkaktojë “ luftra” e “armiçësira” duke lënë pasoja të rënda.

Reduktimi i këtij fenomeni duhet të fillojë nga vetë individët të cilët duhet të ndërgjegjësohen për pasojat që përdorimi i gjuhës së urrejtjes ka. Ato që e praktikojnë, duhet të heqin dorë, ndërsa ato që janë viktimë, duhet të kërkojnë ndihmë profesionale dhe mbështetjen e familjarëve.

Për më tepër, shtetet, institucionet joqeveritare, institucionet jofitimprurëse apo organizata të ndryshme kombëtare apo ndërkombëtare, duhet të ndërmarrin nisma të vazhdueshme për ndërgjegjësimin e masës, përmirësimin e legjislacionit dhe akteve ligjore në fuqi për reduktimin sa më shumë të jetë e mundur të këtij fenomeni.

Për të miturit apo të rinjtë, të cilët mendohet të mos jenë në pjekurinë e duhur mendore për të kuptuar pasojat e gjuhës së urrejtjes në mediat online, prindërit apo kujdestarët këshillohen t'i mbikqyrin në mënyrë të vazhdueshmë përmbajtjen e portaleve që fëmija i tyre lexon apo ndjek në mediat online.

7. BIBLIOGRAFIA

7.1 Burime Shkencore

- Al Hassan, A., & Al-Dossari, H. (2019). DETECTION OF HATE SPEECH IN SOCIAL NETWORKS: A SURVEY ON MULTILINGUAL CORPUS .
- Albadi, N., Kurdi, M., & Mishra, S. (2018). , “Are they Our Brothers? Analysis and Detection of Religious Hate Speech in the Arabic Twittersphere,. *IEEE/ACM Int. Conf. Adv. Soc. Networks Anal. Min*, (pp. 69-76).
- Alrehili, A. (2019). Automatic Hate Speech Detection on Social Media: A Brief Survey. *2019 IEEE/ACS 16th International Conference on Computer Systems and Applications (AICCSA)*.
- Balkin, J. M. (2004). Digital speech and democratic culture: A theory of freedom of expression for the information society. *NyuL rev*, 79.
- Banks, J. (2010). Regulating Hate Speech Online. *International Review Of Law, Computers & Technology* (3), 233.
- Bonotti, M. (2017). Religion, Hate Speech, and Non-Domination. *Ethnicities, Vol. 17, No 2*. UK: Sage Publications.
- Chrysochou, P. (2017). Consumer Behavior Research Methods. In G. Emilien, & W. Weitkunat, *Consumer Perception of Product Risks and Benefits* (pp. 409-428). Springer.
- Citron, D. K. (2011). Intermediaries and Hate Speech: Fostering Digital Citizenship for Our Information Age. (p. 1435). *Boston University Law Review*, (4).
- Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore. (2016). *Ndikimi i Gjuhes se Urrejtjes si Mjet Politik ne Kosove*.
- Gelashvili, T. (2018). *Hate Speech on Social Media: Implications of private regulation and governance gaps* . Lund University.
- GJERGJI, B. (2018, Nentor 14). Realiteti i mediave audiovizuale dhe gjuha e urrejtjes. *Raporti i Autoritetit te Mediave Audiovizive (AMA)*, pp. 10-18.

- Hanzelka, J. &. (2017). Dynamics of cyber hate in social media: A comparative analysis of Anti-Muslim movements in the Czech Republic and Germany. *International Journal of Cyber Criminology*, 11(1), 147.
- Holden, M. T. (2004). Choosing the Appropriate Methodology: Understanding Research Philosophy. *The Marketing Review* 4(4).
- Keshilli European. (2001). *Konventa e Krimet Kibernetik*. Strasbourg, France: Keshilli European.
- Kushtetuta e Kosoves. (n.d.). Republika e Kosoves.
- Parlamenti European. (2020). *Hate speech and hate crime in the EU and the evaluation of online content regulation approaches*. European Union.
- Saha, K., Chandrasekharan, E., & De Choudhury, M. (2019). Prevalence and Psychological Effects of Hateful Speech in Online College Communities. *Proc ACM Web Science Conference*, (pp. 255-264).
- Saunders, M., Lewis, P., & Thornhill, A. (2007). *Research Methods for Business Students*.
- Shaw, L. (2011). Hate Speech in Cyberspace: Bitterness without Boundaries. *Notre Dame Journal of Law, Ethics and Public Policy* 25(1), 279-304.
- Stebbins, R. A. (2001). *Exploratory Research in the Social Sciences (1st edition)*. Sage Publications.
- UN BROADBAND COMMISSION . (2015). *Cyber violence against women and girls*.
- Zhu, Z., & G., L. (2018). The Integration and Development of Online New Media Marketing and Traditional Marketing. *Advances in Social Science, Education and Humanities Research (ASSEHR)*, volume 199, (pp. 461-466).

7.2 Burime nga Interneti

- <https://hrrp.eu/alb/docs/CCPR-a.pdf> (Gjendja 24.11.2020)
- <https://al.ejo-online.eu/media-dhe-politika/liria-e-medias/gjuha-e-urrejtjes-rastet-krasuese-ne-raportet-europiane> (Gjendja 24.11.2020)
- <https://www.theguardian.com/technology/2016/may/31/facebook-youtube-twitter-microsoft-eu-hate-speech-code> (Gjendja 24.11.2020)

- <https://www.theguardian.com/technology/2013/may/29/facebook-campaign-violence-against-women?CMP=EMCNEWEML6619I2> (Gjendja 24.11.2020)
- <https://www.evropaelire.org/a/30101463.html> (Gjendja 26.11.2020)
- <https://impakter.com/hurt-feelings-real-danger-hate-speech/#:~:text=Science%20backs%20up%20the%20idea,our%20empathy%20for%20other%20people.> (Gjendja 26.11.2020)
- <https://www.coe.int/en/web/european-commission-against-racism-and-intolerance/hate-speech-and-violence#:~:text=Hate%20speech%20covers%20many%20forms,and%20the%20rl%20of%20law.> (Gjendja 28.11.2020)
- [www.coe.int/t/dghl/standardsetting/hrpolicy/other_committees/dhlgbt_docs/CM_Re c\(97\)20_en.pdf](http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/hrpolicy/other_committees/dhlgbt_docs/CM_Re c(97)20_en.pdf) (Gjenda 29.11.2020)
- www.aedh.eu/plugins/fckeditor/userfiles/file/Discriminations%20et%20droits%20des%20minorités/Hate%20speech.pdf (Gjendja 30.11.2020)
- www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/ccpr.aspx (Gjendja 01.12.2020)
- <https://telegrafi.com/per-dy-dite-ne-prishtine-po-mbahet-konferenca-e-madhe-rajonale-per-siguri-kibernetike-foto/> (Gjendja 01.12.2020)
- <https://tif.ssrc.org/2019/01/18/religion-and-hate-speech/> (Gjendja: 09.12.2020)
- <https://www.reporter.al/gjuha-e-urrejtjes-ne-media-targeton-grate-dhe-komunitetet-e-margjinalizuar/> (Gjendja: 15.12.2020)